



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu *
edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

Marrëdhënia midis vetefikasitetit dhe qëndrimeve të mësimdhënësve ndaj arsimimit të nxënësve të talentuar dhe me intelegjencë mbi mesatare

Autori:

Edita Bajraktari

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Donika Koliqi

Programi:

Master, Mësimdhënia dhe Kurrikula

Viti akademik:

2025/2026

Hyrja

Çdo nxënës në Kosovë duhet të ofrohet në kuadër të një arsimimi gjithëpërfshirës dhe të barabartë, të përshtatur me nevojat dhe predispozitat e nxënësit individual. Nxënësit e talentuar, me intelegjencë mbi mesatare, me dhunti kanë nevojë të veçanta mësimore. Megjithatë, këta individ shkollohen në institucionet e arsimit formal me bashkëmoshatarët e tyre. Në mënyrë që nxënësit me dhunti të arrijnë një edukim cilësor, është e nevojshme të përcaktohen qëndrimet dhe perceptimet e mësimdhënësve. Ekziston një literaturë e gjerë mbi qëndrimet e mësimdhënësve ndaj edukimit të nxënësve të tyre me dhunti, në të cilën ekziston mospërputhje lidhur me këto qëndrime. Megjithatë, në vendin tonë, nuk është hasur një studim i kryer me mësimdhënës që shqyrton marrëdhënien midis qëndrimit dhe vetefikasitetit të tyre në lidhje me edukimin e nxënësve me dhunti. Në këtë aspekt, mendohet se studimi aktual do të kontribuojë për të zbuluar nëse ka një lidhje midis qëndrimit dhe vetefikasitetit ndaj edukimit të nxënësve me dhunti. Gjithashtu, mendohet se ky studim ka një rëndësi të madhe në sfidat e

edukimit të nxënësve me dhunti. Qëllimi i këtij hulumtimi është të hetojë nëse ekziston një lidhje domethënëse ndërmjet qëndrimeve dhe vetefikasitetit të mësimdhënësve të shkollave fillore ndaj arsimimit të nxënësve të talentuar dhe me intelegjencë mbi mesatare; niveli i besimit dhe qëndrimit në vetefikasitetin dhe nëse ato ndryshojnë sipas variablave të ndryshëm. Studimi eksploron sfidat me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit e nxënësve të talentuar dhe me intelegjencë mbi mesatare.

Pyetjet kryesore të hulumtimit janë:

Qasja kuantitative

1. Cila është marrëdhënia midis nivelit të vetefikasitetit dhe qëndrimit të mësimdhënësve të shkollave fillore në lidhje me arsimimin e nxënësve me dhunti?
2. Cili është niveli i qëndrimeve të mësimdhënësve të shkollave fillore ndaj arsimimit të nxënësve të talentuar dhe me intelegjencë mbi mesatare?
- 2.1 Cili është dallimi i qëndrimeve të mësimdhënësve të shkollave fillore ndaj arsimimit të nxënësve të talentuar dhe me intelegjencë mbi mesatare në varësi nga mosha, kualifikimi akademik dhe përvoja e punës?
3. Cili është niveli i vetefikasitetit të mësimdhënësve të shkollave fillore ndaj arsimimit të nxënësve të talentuar dhe me intelegjencë mbi mesatare?
- 3.1 Cili është dallimi i nivelit të vetefikasitetit të mësimdhënësve të shkollave fillore ndaj arsimimit të nxënësve të talentuar dhe me intelegjencë mbi mesatare në varësi nga mosha, kualifikimit akademik dhe përvoja e punës?

Qasja kualitative

1. Si e perceptojnë vetefikasitetin e tyre mësimdhënësit për të punuar me nxënës të talentuar dhe me intelegjencë mbi mesatare?
2. Cilat janë sfidat e mësimdhënësve gjatë punës me nxënës të talentuar dhe me intelegjencë mbi mesatare?

Metodologjia

Në këtë studim është zbatuar qasja mikse apo e perzier. Ky studim është bazuar në eksperiencën e 161 mësimdhënësve të nivelit fillor në Kosovë, me qëllim të eksplorimit të vetë efikasitetit dhe qëndrimeve të tyre ndaj arsimimit të nxënësve me dhunti. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur pyetësori dhe intervista gjysmë e strukturuar. Të dhënat e mbledhura

për studimin kërkimor kuantitativ u analizuan duke përdorur programin SPSS, kurse për të dhënat cilësore është përdorur analiza tematike.

Rezultatet kryesore

Rezultatet e këtij studimi tregojnë një lidhje pozitive dhe statistikisht domethënëse ndërmjet vetefikasitetit dhe qëndrimeve të mësimdhënësve ndaj arsimimit të nxënësve me dhunti, duke konfirmuar se besimi në aftësitë profesionale ndikon drejtpërdrejt në qëndrimet e tyre. Mësimdhënësit shfaqin qëndrime pozitive, por jo në nivel shumë të lartë, ndërsa vetefikasiteti i tyre paraqitet në nivel mesatar. U gjetën dallime domethënëse në qëndrime sipas moshës dhe përvojës së punës, por jo sipas kualifikimit akademik. Në tërësi, gjetjet theksojnë se, përkundër një baze pozitive në qëndrime dhe vetefikasitet, mungesa e trajnimeve specifike dhe mbështetjes institucionale mbetet sfida kryesore për zbatimin efektiv të praktikave me nxënësit me dhunti.

Diskutimi

Duke qenë se vetë shqyrtimi i literaturës në këtë punim tregon qartë se edukimi i nxënësve me dhunti nuk mund të reduktohet në njohjen formale të potencialit të tyre, por kërkon qëndrime të favorshme, vetëbesim profesional dhe kapacitet real për diferencim pedagogjik, gjetjet e këtij studimi marrin një rëndësi të veçantë teorike dhe praktike. Literatura e vendos qartë problemin në një kuadër ku mësimdhënësi nuk është vetëm transmetues i njohurisë, por faktor vendimtar në identifikimin, motivimin, përkrahjen dhe zhvillimin e nxënësve me dhunti. Në këtë kuptim, çdo interpretim i gjetjeve duhet të shihet jo vetëm si pasqyrim i qëndrimeve individuale të mësimdhënësve, por edhe si tregues i gjendjes së përgjithshme të sistemit arsimor në raport me këtë kategori nxënësish. Të dhënat statistikore tregojnë prirjet e përgjithshme, ndërsa të dhënat kualitative zbulojnë përvojat, arsyetimet dhe kufizimet konkrete që qëndrojnë pas këtyre prirjeve.

Rezultatet treguan se ekziston një lidhje pozitive dhe statistikisht domethënëse midis vetefikasitetit dhe qëndrimeve të mësimdhënësve ndaj arsimimit të nxënësve me dhunti.

Rezultatet treguan se qëndrimet e mësimdhënësve ndaj arsimimit të nxënësve me dhunti janë përgjithësisht pozitive, por jo në mënyrë të njëtrajtshme dhe jo në nivel shumë të lartë; Ekzistojnë dallime statistikisht të rëndësishme në qëndrimet e mësimdhënësve sipas moshës

dhe përvojës së punës, ndërsa nuk u gjetën dallime domethënëse sipas nivelit të kualifikimit akademik; Niveli i vetefikasitetit të mësimdhënësve ndaj arsimimit të nxënësve me dhunti është në nivel mesatar, çka është një gjetje me peshë të madhe; Mosha, kualifikimi akademik dhe përvoja e punës kanë lidhje me vetefikasitetin në mënyra më të dukshme sesa me qëndrimet. Pjesa kualitative e studimit tregon se mësuesit e kuptojnë shumë mirë rolin e tyre në mbështetjen akademike dhe emocionale të nxënësve, por paralelisht e përjetojnë veten si jo plotësisht të përgatitur dhe e perceptojnë mbështetjen institucionale si të kufizuar, sidomos për shkak të mungesës së trajnimeve specifike dhe fokusit jo të mjaftueshëm të trajnimeve ekzistuese.

Përfundimet dhe rekomandimet

Si përfundim, pjesa sasiore tregon se ekziston një bazë pozitive tek mësimdhënësit: qëndrimet janë përgjithësisht pozitive dhe vetefikasiteti nuk është i ulët. Pjesa cilësore, megjithatë, tregon qartë se kjo bazë pozitive shpesh ndeshet me kufizime të forta në praktikë. Ky studim e ka arritur qëllimin e vet, duke treguar se ekziston një marrëdhënie domethënëse dhe pozitive ndërmjet vetefikasitetit dhe qëndrimeve të mësimdhënësve ndaj arsimimit të nxënësve me talent dhe me intelegjencë mbi mesatare. Gjetjet tregojnë se mësimdhënësit kanë përgjithësisht qëndrime pozitive dhe një nivel mesatar vetefikasiteti, por përballen me sfida serioze që lidhen me mungesën e trajnimeve specifike, mungesën e burimeve mësimore, mungesën e kurrikulës së diferencuar dhe mbështetjen e kufizuar institucionale. Kjo do të thotë se zhvillimi i arsimit për nxënësit me dhunti në Kosovë nuk mund të mbështetet vetëm në vullnetin dhe përkushtimin individual të mësimdhënësve, por kërkon ndërhyrje më të strukturuar në nivel institucional dhe politik. Rritja e vetefikasitetit përmes trajnimeve të vazhdueshme, krijimi i mekanizmave më funksionalë për identifikimin dhe mbështetjen e nxënësve me dhunti, si dhe sigurimi i kushteve më të përshtatshme për punë në shkollë, janë hapa të domosdoshëm për të garantuar një arsimim më cilësor, më gjithëpërfshirës dhe më të drejtë për këtë kategori nxënësish.

Fjalët kyçe: *dhunti, mësimdhënës, qëndrim, sfida, talent, vetefikasitet*

Extended Abstract

Title of the Paper:

The relationship between self-efficacy and teachers' attitudes towards the education of talented and above-average students

Author:

Edita Bajraktari

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Donika Koliqi

Program:

Master, Teaching and Curriculum

Academic Year:

2025/2026

Introduction

Every student in Kosovo should be provided with a comprehensive and equal education, adapted to the needs and predispositions of the individual student. Gifted, above-average, and gifted students have special learning needs. However, these individuals are educated in formal education institutions with their peers. In order for gifted students to achieve a quality education, it is necessary to determine the attitudes and perceptions of teachers. There is a vast literature on teachers' attitudes towards the education of their gifted students, in which there is inconsistency regarding these attitudes. However, in our country, no study has been found that examines the relationship between their attitude and self-efficacy regarding the education of gifted students. In this regard, it is thought that the current study will contribute to discovering whether there is a relationship between attitude and self-efficacy towards the education of gifted students. It is also thought that this study has great importance in the challenges of educating gifted students. The purpose of this research is to investigate whether there is a

significant relationship between the attitudes and self-efficacy of primary school teachers towards the education of gifted and above-average intelligence students; the level of confidence and attitude in self-efficacy and whether they vary according to different variables. The study explores the challenges faced by teachers of gifted and above-average intelligence students.

The main research questions are:

Quantitative approach

1. What is the relationship between the level of self-efficacy and the attitude of primary school teachers towards the education of gifted students?
 2. What is the level of attitudes of primary school teachers towards the education of gifted and above-average intelligence students?
- 2.1. What is the difference in the attitudes of primary school teachers towards the education of gifted and above-average intelligence students depending on age, academic qualification and work experience?
3. What is the level of self-efficacy of primary school teachers towards the education of gifted and above-average intelligence students?
- 3.1. What is the difference in the level of self-efficacy of primary school teachers towards the education of gifted and above-average intelligence students depending on age, academic qualification and work experience?

Qualitative approach

1. How do teachers perceive their self-efficacy to work with gifted and above-average intelligence students?
2. What are the challenges of teachers when working with gifted and above-average intelligence students?

Methodology

A mixed or blended approach was applied in this study. This study is based on the experience of 161 primary school teachers in Kosovo, with the aim of exploring their self-efficacy and attitudes towards the education of gifted students. A questionnaire and semi-structured interviews were used to collect data. The data collected for the quantitative research study were analyzed using the SPSS program, while thematic analysis was used for the qualitative data.

Main Results

The results of this study show a positive and statistically significant relationship between self-efficacy and teachers' attitudes towards the education of gifted students, confirming that confidence in professional abilities directly influences their attitudes. Teachers display positive attitudes, but not at a very high level, while their self-efficacy is presented at an average level. Significant differences in attitudes were found according to age and work experience, but not according to academic qualification. Overall, the findings emphasize that, despite a positive basis in attitudes and self-efficacy, the lack of specific training and institutional support remains the main challenge for the effective implementation of practices with gifted students.

Discussion

Since the literature review in this paper clearly shows that the education of gifted students cannot be reduced to the formal recognition of their potential, but requires favorable attitudes, professional self-confidence and a real capacity for pedagogical differentiation, the findings of this study take on a special theoretical and practical importance. The literature clearly places the problem in a framework where the teacher is not only a transmitter of knowledge, but a decisive factor in the identification, motivation, support and development of gifted students. In this sense, any interpretation of the findings should be seen not only as a reflection of the individual attitudes of teachers, but also as an indicator of the general state of the education system in relation to this category of students. Statistical data show general trends, while

qualitative data reveal the experiences, justifications and concrete limitations that lie behind these trends.

The results showed that there is a positive and statistically significant relationship between self-efficacy and teachers' attitudes towards the education of gifted students.

The results showed that teachers' attitudes towards the education of gifted students are generally positive, but not uniformly and not at a very high level; There are statistically significant differences in teachers' attitudes according to age and work experience, while no significant differences were found according to the level of academic qualification; The level of teachers' self-efficacy towards the education of gifted students is at an average level, which is a finding of great importance; Age, academic qualification and work experience are related to self-efficacy in more obvious ways than to attitudes. The qualitative part of the study shows that teachers understand very well their role in the academic and emotional support of students, but at the same time they experience themselves as not fully prepared and perceive institutional support as limited, especially due to the lack of specific training and the insufficient focus of existing training.

Conclusions and recommendations

In conclusion, the quantitative part shows that there is a positive basis among teachers: attitudes are generally positive and self-efficacy is not low. The qualitative part, however, clearly shows that this positive basis often faces strong limitations in practice. This study has achieved its goal, showing that there is a significant and positive relationship between self-efficacy and teachers' attitudes towards the education of gifted and above-average intelligence students. The findings show that teachers generally have positive attitudes and an average level of self-efficacy, but face serious challenges related to the lack of specific training, the lack of teaching resources, the lack of differentiated curriculum and limited institutional support. This means that the development of education for gifted students in Kosovo cannot rely solely on the will and individual commitment of teachers, but requires more structured interventions at the institutional and political level. Increasing self-efficacy through continuous training, creating more functional mechanisms for identifying and supporting gifted students, and ensuring more suitable conditions for working in school are

necessary steps to guarantee a higher quality, more inclusive and fairer education for this category of students.

Keywords: *giftedness, teacher, attitude, challenge, talent, self-efficacy*